

Kastrati Hotels & Tower shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë Kastrati Hotels & Tower shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Kastrati Hotels & Tower shpk** (më poshtë Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e performancës dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020 performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.6 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.

mazars

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë

15 korrik 2021

mazars
Emin Duraku SHK, Shijakët, Brukselë
No.5, 1013, Tiranë, Albania
NUIIS: K32123006W

Irena Hoxha (Puló)
Auditues Ligjor

Kastrati Hotels & Tower shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019	
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,744,776	23,281,733
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	8,666,457	20,997,593
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	43,795,199	38,191,767
Llogari të arkëtueshme te tjera	7	701,650	-
Inventarë	8	10,088,487	16,962,222
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	74,305,731	53,905,298
Totali i aktiveve afatshkurtra		141,302,300	153,338,613
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	2,069,984,567	2,106,108,716
Totali i aktiveve afatgjata		2,069,984,567	2,106,108,716
Totali i aktiveve		2,211,286,867	2,259,447,329
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	18	7,343,893	-
Llogari të pagueshme tregtare	11	37,324,298	57,775,349
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	172,206,872	66,924,931
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	13	2,023,913	3,682,016
Detyrime tatimore	14	2,219,999	5,203,035
Parapagime të marra	15	8,623,371	8,819,128
Të tjera detyrime		91,725	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		229,834,071	142,404,459
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	18	3,671,959	-
Provizione	16	16,780,996	17,995,079
Totali i detyrimeve afatgjata		20,452,955	17,995,079
Totali i detyrimeve		250,287,026	160,399,538
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		2,184,746,764	2,184,746,764
Fitime të mbartura		(85,698,973)	(63,192,081)
Fitimi i ushtrimit		(138,047,950)	(22,506,892)
Totali i kapitalit	17	1,960,999,841	2,099,047,791
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,211,286,867	2,259,447,329

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Kastrati Hotels & Tower shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	129,529,307	442,195,425
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	3,469,020	5,341,677
Total të ardhura		132,998,327	447,537,102
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(135,899,731)	(271,804,621)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	21	(27,428,693)	(113,039,360)
2) Të tjera shpenzime	22	(108,471,038)	(158,765,261)
Shpenzime të personelit	23	(92,387,720)	(152,739,313)
1) Paga dhe shpërblime		(79,691,811)	(133,873,723)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(12,695,909)	(18,865,590)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(36,329,009)	(36,301,575)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(6,401,167)	(9,198,485)
Shpenzime financiare		(28,650)	-
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	25	(28,650)	-
Fitimi/humbja para tatimit		(138,047,950)	(22,506,892)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(138,047,950)	(22,506,892)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(138,047,950)	(22,506,892)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 24 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Kastrati Hotels & Tower shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	2,184,746,764	-	(63,192,081)	2,121,554,683
Transferim në fitime të mbartura	-	(63,192,081)	63,192,081	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(22,506,892)	(22,506,892)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	2,184,746,764	(63,192,081)	(22,506,892)	2,099,047,791
Transferim në fitime të mbartura	-	(22,506,892)	22,506,892	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(138,047,950)	(138,047,950)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	2,184,746,764	(85,698,973)	(138,047,950)	1,960,999,841

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Kastrati Hotels & Tower shpk më _____

Elsi Keco

Elsi Keco

Administratori



Kastrati Hotels & Tower shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	(138,047,950)	(22,506,892)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36,329,009	36,301,575
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Diferenca nga kurset e kembimit	(176,210)	-
Te ardhura nga interesi	(28,650)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	6,026,054	(34,289,570)
Rritje/(rënie) në inventar	6,873,735	(2,197,024)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	80,281,476	103,828,553
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(20,400,433)	(53,075,298)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(195,757)	1,329,989
Provizione	(1,214,083)	(6,748,416)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(30,552,809)	22,642,917
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</i>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	(5,769,406)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	(5,769,406)
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</i>		
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	7,343,893	-
Rënie/(rritje) në huadhënie afatshkurtër	3,671,959	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	11,015,852	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(19,536,957)	16,873,511
Mjetet monetare në fillim të periudhës	23,281,733	6,408,222
Mjetet monetare në fund të periudhës	3,744,776	23,281,733

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Kastrati Hotels & Tower shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Kastrati Hotels & Tower shpk është një shoqëri e regjistruar më 6 shtator 2018 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka NIPT L82106038D. Selia e shoqërisë është Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Tiranë. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një vlerë totale 2,184,746,764 LEK i ndarë në 2 kuota. Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Kastrati Group me 80 % pjesëmarrje.
- 2- Fulmer Holding me 20 % pjesëmarrje.

Administrator i shoqërisë është Z. Elsi Keco.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është veprimtari tregtare të import eksportit, të turizmit; administrim e menaxhim hotelerie.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKKP) dhe ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.



3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
EURO/ LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Aktivitet financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit për vitin 2020 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit ne %
Ndërtesa	5%
Makineri dhe pajisje	20%
Pajisje informatike	25%
Mobilje zyre	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% .

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	3,341,025	21,251,538
Mjete monetare në arkë	403,751	2,030,195
	3,744,776	23,281,733

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Klientë në dhoma	461,989	1,544,194
Klientë të larguar	8,204,468	19,453,399
	8,666,457	20,997,593



Kastrati Hotels & Tower shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Pala e lidhur Kastrati sha - Kapitali	-	800,000
AUTO STAR ALBANIA	37,306,578	37,306,578
Kastrati Residence	-	85,189
Pala e lidhur Pronari	6,488,621	-
	<u>43,795,199</u>	<u>38,191,767</u>

7. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogari të arkëtueshme të tjera paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH e rimbursueshme	322,506	-
TE tjera te arketueshme	379,144	-
	<u>701,650</u>	<u>-</u>

8. Inventari

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Ushqime	1,529,667	5,316,588
Pije	3,838,404	5,787,857
Inventar operativ	4,720,416	5,857,777
	<u>10,088,487</u>	<u>16,962,222</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagim per ndertime	69,961,419	49,259,142
Parapagim per tatim fitimi	20,000	20,000
Shpenzime të shtyra	4,324,312	4,626,156
	<u>74,305,731</u>	<u>53,905,298</u>



Kastrati Hotels & Tower shpk
 Shënimit e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
 (Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Toka, troje dhe terrere			Ndërtesa	Te tjera	Totali
Kosto						
Gjendja me 1 Janar 2019	32,231,401	1,889,280,920	251,310,080			2,172,822,401
Shtesa			5,769,406			5,769,406
Gjendja më 31 dhjetor 2019	32,231,401	1,889,280,920	257,079,486			2,178,591,807
Shtesa			204,860			204,860
Gjendja më 31 dhjetor 2020	32,231,401	1,889,280,920	257,284,346			2,178,796,667
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja me 1 Janar 2019	-	23,616,012	12,565,504			36,181,516
Amortizimi i vitit		23,616,012	12,685,563			36,301,575
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	47,232,024	25,251,067			72,483,091
Amortizimi i vitit		23,616,012	12,712,997			36,329,009
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	70,848,036	37,964,064			108,812,100
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	32,231,401	1,842,048,896	231,828,419			2,106,108,716
Gjendja më 31 dhjetor 2020	32,231,401	1,818,432,884	219,320,282			2,069,984,567



(Vlerat janë në Lek)

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë	37,324,298	57,775,349
	<u>37,324,298</u>	<u>57,775,349</u>

12. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare - MAK Albania	21,714,643	19,116,449
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati shpk	32,633,415	23,605,084
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati sha	3,142,455	3,142,455
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati Group	263,076	-
Llogari të pagueshme tregtare - Autostar Albania	2,675,550	2,576,156
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati Residences shpk	48,493,839	2,210,640
Llogari të pagueshme tregtare - Kastrati Energy	-	3,655,312
Llogari të pagueshme tregtare - Kast & Gas	52,486,730	-
Llogari të pagueshme tregtare - Albsig	1,784,500	-
Llogari të pagueshme tregtare - Loxdon	9,012,664	9,012,664
Pala e lidhur Pronari	-	3,606,171
	<u>172,206,872</u>	<u>66,924,931</u>

13. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Llogaritë e pagueshme për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shpenzime të konstatuara	2,023,913	3,682,016
	<u>2,023,913</u>	<u>3,682,016</u>



(Vlerat janë në Lek)

14. Detyrime Tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime TVSH	-	813,852
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,701,896	2,813,161
Detyrime për taksën e fjetjes	31,850	577,203
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat	486,253	998,819
	2,219,999	5,203,035

15. Parapagime të marra

Detyrimet për parapagimet e marra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime për evente	8,623,371	8,819,128
	8,623,371	8,819,128

16. Provizione

Provizionet më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Provizione	16,780,996	17,995,079
	16,780,996	17,995,079

17. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 2,184,746,764 LEK i zotëruar nga ortakët si vijon:

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Kuota	Vlera në para	%	Kuota	Vlera në para	%
Kastrati Group	1	1,747,797,411	80%	1	1,747,797,411	80%
Fulmer Holding	1	436,949,353	20%	1	436,949,353	20%
	2	2,184,746,764	100%	2	2,184,746,764	100%



(Vlerat janë në Lek)

18. Huamarrje

Gjendja e huamarrjeve paraqitet si me poshtë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Hua afatshkurtë	(7,343,893)	-
Hua afatgjatë	(3,671,959)	-
	(11,015,852)	-

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga dhomat	48,868,267	214,280,830
Të ardhura nga pijet dhe ushqimi	55,687,792	195,961,578
Te ardhura nga fitnes	6,780,641	7,187,551
Te ardhura nga qeraja e dyqaneve	13,866,849	9,843,158
Te ardhura nga lavanderia	670,243	1,560,581
Te ardhura nga transporti	1,193,490	2,653,840
Të ardhura të tjera	2,462,025	10,707,887
	129,529,307	442,195,425

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në		
Qarkullim i tatueshëm	145,079,140	464,589,100
Ushqimi per stafin (pritet fature dhe nuk deklarohet e ardhur)	(7,749,819)	(13,294,328)
Mallra dhe sherbime te konsumuara nga stafi menaxherial	(6,309,192)	(8,009,085)
Faturim ne emer te bleresit gabimisht ne liber shitje	(284,712)	-
Skontot e aplikuara	(788,190)	(310,564)
Faturim per kreditim te pjesshem	(417,920)	(779,698)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	129,529,307	442,195,425
Sipas Kontabilitetit	129,529,307	442,195,425
Diferenca	-	-



(Vlerat janë në Lek)

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Te ardhura nga rimarrja e provizionit		6,794,162
Te ardhura te tjera	3,650,000	-
Fitim/ humbja kursi kembimit	(180,980)	(1,452,485)
	3,469,020	5,341,677

21. Lënde e pare, materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Kosto e mallrave të shitura	22,753,642	103,375,003
Materiale te konsumueshme	4,675,051	9,664,357
	27,428,693	113,039,360

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Energji elektrike, uje	25,053,284	43,561,941
Qera	4,725,311	8,071,473
Shpenzime sigurimi	5,000	3,470,000
Lende djegese	27,094,003	38,310,195
Taksa vendore	8,861,590	7,976,030
Konsulenca	1,577,245	5,664,746
Mirembajtje IT	3,486,631	7,160,658
Komisione per prenotime online	1,957,585	5,903,710
Mirembajtje per hotelin	5,545,303	15,779,300
Marketing dhe promocion	788,427	1,012,916
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	1,368,190	2,120,174
Abonime dhe licensa	620,663	1,742,896
Shpenzime udhetimi	3,099,346	551,936
Trajnime	12,611,289	1,241,426
Prime sigurimi	2,091,438	897,373
Komisione bankare	1,200,884	3,665,362
Kancelari	438,443	2,068,651
Të tjera shpenzime	7,946,406	9,566,474
	108,471,038	158,765,261



Kastrati Hotels & Tower shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime paga	79,691,811	133,873,723
Shpenzime per sigurime shoqerore	12,695,909	18,865,590
	92,387,720	152,739,313

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime per personelin	6,401,167	9,198,485
	6,401,167	9,198,485

25. Shpenzime financiare

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime financiare	28,650	-
	28,650	-

26. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Fitimi para tatimit</i>	(138,047,950)	(22,506,892)
Total shpenzime të panjohura	16,476,013	11,751,311
Shpenzime per pritje percjellje	2,906,666	58,425
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	135,060	25,050
Shpenzime të tjera	13,434,287	11,667,836
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	(121,571,937)	(10,755,581)

Humbje fiskale e mbartur

Tatim fitimi @15%

	-	-
	(138,047,950)	(22,506,892)



(Vlerat janë në Lek)

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
AUTO STAR ALBANIA	31,897,653	2,675,550	31,897,653	2,576,156
KST Advertising	695,296	-	695,296	-
Albsig	-	1,784,500	-	-
KASTRATI shpk	-	32,633,415	-	23,605,084
KASTRATI SHA	-	3,142,455	800,000	3,142,455
Kastrati Construction	-	-	4,713,630	-
KASTRATI GROUP	4,713,630	263,076	-	-
KASTRATI RESIDENCES	-	48,493,839	85,188	2,210,640
Mardhenie me ortakun	6,488,620	-	-	3,606,171
Loxdon shpk	-	9,012,664	-	9,012,664
MAK ALBANIA	-	21,714,643	-	19,116,450
KASTRATI ENERGY	-	-	-	3,655,312
KAST & GAS	-	52,486,730	-	-
	43,795,199	172,206,872	38,191,767	66,924,931

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
AUTO STAR ALBANIA	-	82,828	-	2,446,945
Albsig	9,571,785	2,193,238	-	2,213,291
KASTRATI shpk	227,708	16,048,895	160,402	32,623,595
KASTRATI SHA	-	-	-	1,722,188
Kastrati Construction	875	-	90,714	-
KASTRATI GROUP	-	219,230	-	406,976
KASTRATI RESIDENCES	-	2,583,932	-	2,594,110
LOXDON shpk	205,000	-	5,150	7,510,553
MAK ALBANIA	-	2,125,026	801,390	15,132,369
KASTRATI ENERGY	-	-	-	24,443,928
	10,005,368	23,253,149	1,057,656	89,093,955



28. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare.

